

RAPORT VEPRIMTARIS 2023

I E K A

Qershor 2024



Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) u krijua më datën 24 Nëntor 1997, me statusin e një organizate profesionale jo fitimprurëse, që grupon profesionistët kontabël të pajisur me titullin "Auditues Ligjor" (titull i ndryshuar në vitin 2016), të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në praktikë:

1. Në mënyrë individuale, si person fizik
2. Si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese
3. Si i punësuar tek një tjetër auditues ligjor i regjistruar

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ka për objekt të veprimtarisë së tij të sigurojë ushtrimin e profesionit të audituesve ligjorë në përputhje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij.

Misioni i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) është të rregullojë organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara të shoqërive tregtare në zbatim të ligjit Nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar" të ndryshuar me ligjin 47/2016.

Për të siguruar një vazhdimësi të profesionit të Audituesit Ligjor, Instituti synon të mbështetet në modele dhe eksperiencë të përparuara duke kombinuar përmirësimin e legjislacionit me edukimin e anëtarëve nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve profesionale cilësore nga trajnerë me përvojën më të mirëvendase dhe të huaj.

Sipas Ligjit të Auditimit, **Këshilli Drejtues i IEKAs** kryen drejtimin e veprimtarisë së Institutit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me statutin, si dhe me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

Këshilli Drejtues, ka përbërjen e mëposhtme:

- | | |
|----------------------|------------|
| 1. Berti PASHKO | Kryetar |
| 2. Shpresa BREÇANI | Zv/Kryetar |
| 3. Desara LIKO | Anëtar |
| 4. Edrian MESLANI | Anëtar |
| 5. Esmeralda BALLUKU | Anëtar |
| 6. Ilda DUHANXHIU | Anëtar |
| 7. Kamela HASKO | Anëtar |

Këshilli Drejtues i IEKAs përbëhet nga 7 anëtarë. Katër anëtarë janë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme date 15 tetor 2021 me mandat nga 15 tetor 2021 – 15 tetor 2025 (Berti Pashko, Shpresa Breçani, Edrian Meslani, Esmeralda Balluku) dhe tre anëtarët e tjerë janë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme date 14.06.2023 me mandat nga 14.06.2023 – 15 tetor 2025 (Desara Liko, Ilda Duhaxhiu, Kamela Hasko).

Këshilli Drejtues në mbledhjen e datës 1 Nentor 2021 ka zgjedhur Kryetar z. Berti Pashko dhe zv/Kryetar znj. Shpresa Breçani.

Gjatë vitit 2023 Këshilli Drejtues ka realizuar 11 mbledhje dhe ka marrë gjithsej 56 vendime.

Këshilli Drejtues ka kompetencë miratimin e vendimeve, hartimin e akteve nënligjore, të cilat i dërgohen për miratim Asamblesë së Përgjithshme ose sipas rastit edhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike, hartimin e kurrikulave të përgatitjes dhe trajnimeve profesionale për kandidatët, organizimin e kontrollit të cilësisë, etj. Në muajin janar 2023 Këshilli Drejtues ka miratuar Programin e Punës për vitin 2023.

Këshilli Drejtues harton projekt - buxhetin e organizatës profesionale IEKA, vendos për politikën e administrimit dhe për procedurat e përdorimit të mjeteve financiare dhe realizimin e veprimtarisë së tij. Në 31 Maj 2023, Këshilli Drejtues miratoi Projekt- buxhetin e periudhës 2023-2024, i cili u miratua në Asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve të IEKAs në datën 07 Dhjetor të 2023, pasi në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të IEKAs të datës 29 Qershor 2023, për shkak të mos konfirmimit të kuorumit të nevojshëm ky votim u shpall i pavlefshëm. Projekt Buxheti 2023, u hartua në përputhje me parashikimet e zhvillimeve të ardhshme sipas sektorëve për vitin 2023 dhe mbështetur në të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në vitin 2022.

Objektivat kryesore që udhëhoqën hartimin e buxhetit vjetor 2023, synuan funksionimin normal të veprimtarisë së IEKAs, ruajtjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmirësimin e shërbimeve të detyrueshme për anëtarët/kandidatët, etj.

Këshilli Drejtues është informuar nga kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm për sigurimin e respektimit të ligjit dhe të akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të institucionit.

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm është përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar, auditimin e Pasqyrave Financiare vjetore, si edhe përputhshmërinë e veprimtarisë së IEKAs me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komiteti i Kontrollit të Brendshëm përbëhet nga tre anëtarë të miratuar nga Vendimi Nr.153 i Asamblese Përgjithshme e Anëtarëve më datë 11 Janar 2022:

- a. Altin Sulejmani (Kryetar)
- b. Fatmira Kastrati Sykja (Anëtar)
- c. Eljona Hoxha (Anëtar)

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm kontrollon veprimtarinë financiare të Institutit, mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël, pajtueshmërinë e veprimeve të regjistruara në llogari me buxhetin, si dhe rregullsinë dhe korrektësinë e llogarive vjetore të aprovuara nga Këshilli Drejtues.

Në statut është parashikuar që pasqyrat financiare të Institutit do të auditohen nga një auditues ligjor, i cili propozohet nga Komiteti i i Kontrollit të Brendshëm.

Ne Asamblene e e Përgjithshme të Anëtarëve në muajin 07 Dhjetor të 2023, u perzgjodh si Auditues Ligjor për te audituar Pasqyrat Financiare te viteve 2022 dhe 2023, z.Artan Xhiani (UHY ELITE shpk).

Këshilli Drejtues është informuar nga Drejtori Ekzekutiv për realizimin e veprimtarive dhe realizimin e buxhetit në afatet kohore të parashikuara në statut.

Këshilli ka përmbushur rregullisht detyrimet e llogaridhënies ndaj anëtarësisë duke hartuar këtë raport vjetor, pjesë përbërëse të të cilit janë edhe pasqyrat financiare 2023.

Stafi Ekzekutiv i IEKAs funksionon në bazë të strukturës së miratuar nga Këshilli Drejtues dhe të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës Ekzekutive të IEKAs, të miratuar me vendimin nr. 53 datë 05.11.2014 të KD dhe të rishikuar me vendimin nr. 49 datë 04.12.2019 të KD.

Në këtë rregullore është përcaktuar struktura organizative dhe përshkrimet e punës të stafit ekzekutiv. Modeli i strukturës së re është mbështetur në strukturën ekzistuese, ku ende ka mangesi në personel të IEKAs.

Struktura e personelit ekzekutiv përbëhet nga:

Punonjësit me kohë të plotë:

1. Doranin Agalliu - Drejtor Ekzekutiv i Komanduar;
2. Silvi Buzi - Specialist për Burimet Njerëzore dhe sekretari që kryen detyrën e sekretarisë së IEKAs, të Kryetarit dhe të Drejtorit Ekzekutiv;
3. Silda Metani - Sektori i financës e kontabilitetit;
4. Antonela Mersini - Sektori i Edukimit Profesional të Kandidatëve dhe Kualifikimit të Vijueshëm të anëtarëve;
5. Edes Dhales - Sektori i standardeve dhe i publikimeve profesionale;
6. Xhoxhi Lera – Inspektor i Kontrollit të Cilesise,
7. Orjal Shaholli - Inspektor i Kontrollit të Cilesise
8. Albana Pllaha - Specialist i logjistikës dhe shërbimeve të tjera mbështetëse.

Në zbatim të Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilitetit të miratuar“, të ndryshuar, si dhe Statutit të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, neni 26.1, Veprimtaritë administrative të Institutit udhëhiqen nga Drejtori Ekzekutiv, i cili organizon punën për kryerjen e veprimtarive profesionale të Institutit të cilat janë në përputhje me Ligjin apo me vendimet e Këshillit Drejtues. Këtu përfshihen ndjekja dhe organizimi i punës për përditësimin dhe plotësimin e standardeve profesionale, ndihma që i jepet autoriteteve,

komiteteve e komisioneve të ngritura në përputhje me Ligjin, me vendimet të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Asamblesë së Përgjithëshme të Anëtarëve apo Këshillit Drejtues, për kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Gjatë vitin 2023 u zhvillua veprimtaria teknike e profesionale, në zbatim të vendimeve të Këshillit Drejtues si më poshtë vijon:

- Liroi nga detyra anëtarët pjesë përbërëse e Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm dhe Këshillit Botues të Revistës Profesionale pranë IEKAs
- Emëroi në detyrë anëtarët pjesë përbërëse e Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm dhe Këshillit Botues të Revistës Profesionale pranë IEKAs;
- U shpallën vëndet vakante për aplikim në pozicionet e Inspektor të Kontrollit të Cilësisë më shtator 2023 pranë IEKAs;
- U miratua Rregullore e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës
- U miratua Rregullore e Komitetit të Standarteve Profesionale dhe Etikës
- U miratua Rregullore e Komitetit të Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit.
- U miratua Rregullore e Komitetit të Kontrollit të Cilësisë
- U dërguan për miratim rregulloret e Komiteteve pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- U organizua mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme të Anëtarëve për votimin e draft-rregulloreve të Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës, Komitetit të Standarteve Profesionale dhe Etikës, Komitetit të Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit dhe Komitetit të Kontrollit të Cilësisë.
- U shqyrtua çështja e Z. Erind Mërkuri me profesion avokat, i cili ka perfaqesuar IEKA-n ne Gjykatën Administrative te Apelit dhe per pagesen e zhdemtimit nga ane e tij te nje penaliteti te marre nepermjet zyres se permbarimit shteteror.
- Organizimin e miratimin për ngritjen e Grupit të Punës për rishikimin e statutit të IEKA-s;
- U organizua testimi për njohjen e orëve me kërkesë për anëtarët, të cilët nuk kanë përmbushur detyrimin e ndjekjes së kualifikimit të vijueshëm;
- U organizua provimi hyrës për kandidatët për Auditues Ligjor për vitin 2023;
- U organizua mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme të Anëtarëve me datë 29 Qershor 2023 ku nuk u konfirmua kuorumi i nevojshëm ;
- U organizua trajnimi i Anëtarëve Aktiv dhe Pasiv (on line nepermjet platformes ZOOM) të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
- U miratua Marrëveshja midis organizatave të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar (IKM)/ Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë (SHKFSH) dhe IEKA-s në funksion të provimeve të aftësive profesionale;
- U miratua emërimi i Drejtorit Ekzekutiv me afat 4-vjeçar.
- U komunikua me anëtarësinë mbi përcaktimin e kalendarit të sesionit të dytë 2023 për Kualifikimin e Vijueshëm Profesional të cilët përcollën sugjerimet e tyre sipas nevojave përkatëse;

- U zhvilluan modulet e stazhierëve të vitit të parë, vitit të dytë dhe vitit të tretë sipas kalendarit të miratuar;
- U miratua tarifa e rishikimit/ri korigjimit të testimit për kandidatët e Praktikës Profesionale;
- U finalizua përmbushja me sukses e detyrimit të kryerjes së Praktikës Profesionale për kandidatët e vitit të tretë 2023.
- Miratimi i ndryshimit të oreve të punës sipas misionit për tu aprovuar në mbledhjen e radhës së Asamblese së Përgjithshme të Anetareve të IEKAs.

Të tjera çështje:

- Janë përmbushur kërkesat e vazhdueshme të Audituesve Ligjorë si dhe kandidatëve për Auditues Ligjor drejtuar Institutit në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullatorë në fuqi;
- Janë analizuar Deklarimet e Misionëve të Auditimit dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2022 të depozituara nga Audituesit Ligjor Aktiv gjatë vitit 2023;
- Ndjekja e proceseve gjyqësore si vijon:
Proceset gjyqësore të IEKA, ku është edhe paditese dhe e paditur.

IEKA si e paditur:

- **Padites Z. Arqile Mishtaku** me objekt,
 - Pavlefshmërinë absolute të vendimeve të IEKA-s, për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të IEKA-s me datë 15 tetor 2021 dhe vendimeve të marra gjatë kësaj mbledhjeje për shkarkimin e anëtarëve të padorëhequr të Këshillit Drejtues Elton Tirana dhe Arqile Mishtaku dhe për shkarkimin e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm, si dhe vendimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të ri Drejtues me Nr. 147, 148, 149, 150 datë 15.10.2021.
 - Marrjen e masës së sigurimit pezullimin e regjistrimit të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të IEKA të mara në mbledhjen e datës 15 tetor 2021, në shkelje flagrante të ligjit dhe Statutit të IEKA.

është tërhequr nga padia pas disa seancave.

- **Padites znj. Eleonora Olli** me objekt:
 - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Këshillit Drejtues të IEKA nr. extra, datë 16.09.2020;
 - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Këshillit Drejtues të IEKA nr. 48, datë 09.10.2020;
 - Marrjen e masës së sigurisë për vendimin e Këshillit Drejtues të IEKA nr. extra, datë 16.09.2020 dhe vendimin datë 09.10.2020 duke pezulluar zbatimin e tyre deri sa ky vendim të marrë formë të prerë.
- **Padites z. Elton Tirana** me objekt:

- Pavlefshmërinë absolute të vendimeve të IEKA-s, për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të IEKA-s me datë 15 tetor 2021 dhe vendimeve të marra gjatë kësaj mbledhjeje për shkarkimin e anëtarëve të padorëhequr të Këshillit Drejtues Elton Tirana dhe Arqile Mishtaku dhe për shkarkimin e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm, si dhe vendimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të ri Drejtues me Nr. 147, 148, 149, 150 datë 15.10.2021.
- Marrjen e masës së sigurimit pezullimin e regjistrimit të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të IEKA të mara në mbledhjen e datës 15 tetor 2021, në shkelje flagrante të ligjit dhe Statutit të IEKA.

eshte terhequr nga padia pas disa seancave.

- **Padites znj.Elvira Hoxha** si me poshte:

“Gjykata bazuar në Nenet 126 – 306 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në nenet 141-155 të K.Punes ka vendosur :

- Pranimin e pjesëshëm të padisë.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen në masën e 2 (dy) pagave mujore për zgjidhje të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen në masën e 2 (dy) pagave mujore për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen në masën e 2 (dy) pagave mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës.
- Detyrimin e palës së paditur të shpërblejë paditësen për vjetërsinë në punë me pagën e katër 15 (pesëmbëdhjetë ditëshave) ose 2 (dy) muaj.
- Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.
- Ky vendim është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor sapo të marrë formë të prerë.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur në perpjestim me pjesën e pranuar të padisë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi sipas afatit ligjorë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- U shpall në Tiranë në dt.23.06.2023.

Ky vendim është apeluar në Gjykatën e Apelit Tiranë, por nuk është zhvilluar asnjë seance.

- **Paditese Arminda Qylafku**, është pushuar gjykimi i çështjes me nr.15077 akti date regj. 01.08.2023, u shpall date 08.09.2023.

IEKA si padites:

- Kërkesa për depozitimin e Vendimit Nr.48 date 09.10.2020 të Këshillit të Drejtues të IEKAs sipas nenit 16.6 të Statutit të IEKAs, që me Vendimin Nr.3573/10 date 28.12.2020, Gjyqtarja Anila Karanxha ka vendosur bazuar në Nenet 127 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile kthimin e kërkesës së bashku me aktet e çështjes Nr.823 Regjistri Themeltar date 19.10.2020 të kerkuesit;
- Kërkesa për depozitimin e Vendimit Nr.ekstra date 16.09.2020 të Këshillit të Drejtues të IEKAs dhe Vendimit Nr.48 date 09.10.2020 të Këshillit të Drejtues të IEKAs sipas nenit 16.6 të Statutit të IEKAs

qe me Vendimin Nr.3573/11 date 22.04.2021, Gjyqtarja Anila Karanxha ka vendosur bazuar ne ligjin Nr.8788 date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimprurese” vendosi sa me poshte vijon:

- Mospranimin e kerkeses per depozitimin e Vendimit Nr.ekstra date 16.09.2020 te Keshillit te Drejtues te IEKAs
- Mospranimin e kerkeses per depozitimin e Vendimit Nr.48 date 09.10.2020 te Keshillit te Drejtues te IEKAs;

Kunder ketij vendimi eshte bere ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane.

- Kerkese per depozitimin dhe regjistrim te Vendimit Nr.150 date 15.10.2021 te Asamblese se Pergjithshme te Anetareve te Institutit te Eksperteve kontabel te Autorizuar, te vendimit Nr.46 date 01.11.2021 te Keshillit Drejtues te IEKAs dhe vendimit Nr.47 date 09.11.2021 te Keshillit Drejtues te IEKAs qe me Vendimin Nr.3573/12 date 26.01.2022, Gjyqtarja Manjola Xhaxho ka vendosur bazuar ne ligjin Nr.8788 date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimprurese” kthimin e kerkeses te kerkuesit; Ky vendim u apelua ne Gjykatën e Apelit Tirane.
- Gjykatën e Apelit Tirane, Me vendimin Nr.45 date 15.02.2023 me objekt per depozitimin dhe regjistrim te Vendimit Nr.150 date 15.10.2021 te Asamblese se Pergjithshme te Anetareve te Institutit te Eksperteve kontabel te Autorizuar, te vendimit Nr.46 date 01.11.2021 te Keshillit Drejtues te IEKAs dhe vendimit Nr.47 date 09.11.2021 te Keshillit Drejtues te IEKAs ka vendosur bazuar ne nenin 466/b te Kodit te Procedures Civile sa me poshte vijon:
 - Ndryshimin e Vendimit Nr.3573/12 date 26.01.2022 te Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane;
 - Pranimin e kerkeses;
 - Depozitimin dhe regjistrimin e Vendimit Nr.150 date 15.10.2021 te Asamblese se Pergjithshme te Anetareve te Institutit te Eksperteve kontabel te Autorizuar, te vendimit Nr.46 date 01.11.2021 te Keshillit Drejtues te IEKAs dhe vendimit Nr.47 date 09.11.2021 te Keshillit Drejtues te IEKAs;
 - Shpenzimet Gjyqesore sic jane bere;
 - Kunder ketij vendimi lejohet rekurs ne Gjykatën e Larte sipas ligjit.
- Kerkese padi kunder BMP lidhur me shfuqizimin e Rregullores Nr.1 date 26.07.2017 “Per mbledhjen e te ardhurave te BMP ndryshuar me rregulloren Nr.3 date 22.02.2018 te BMP; ne Gjykatën e Apelit Administrativ, eshte ne proces;
- Kerkese padi kunder BMP lidhur me shfuqizimin e Rregullores Nr.4 date 22.02.2018 “Per investigimin dhe procedurat e marrjes se masave disiplinore nga BMP;
- Kerkese padi kunder Autoritetit te Konkurences ne Gjykatën Administrative Tirane per Shfuqizimin e pikës/paragrafit “2” të pjesës urdhëruese të aktit administrativ “Vendimi Nr. 852 Prot datë 24.12.2021 (Nr. 280/13 Prot. datë 24.12.2021) i Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës”, që ka të bëjë me palën paditëse, komunikuar paditësit me anë të shkresës Nr. 257/37 Prot. datë 24.06.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, bazuar ne:
 - Neni 40 i Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar);
 - Neni 11, pika 1, neni 17, pika 1, germa (c), nenet 28 – 30 dhe neni 40, pika 1, germa (c) të Ligjit Nr. 49/2012 datë 03.05.2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar);
 - Nenet 32 dhe 153 të Kodit të Procedurës Civile;

- Nenet 115, 116 dhe 117 të Ligjit 45/ 2014 “Kodi të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Kunder këtij vendimi është bere ankimim.
- U mundësua përmbledhja e standardeve të përkthyer nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SCAAK) si dhe publikimi i tyre për anëtarësinë.

Gjatë vitit 2023 IEKA ka patur në fokus vazhdimin e përpjekjeve për marrjen e delegimit nga BMP të kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike, të cilat nuk janë me interes publik në përputhje me nenin 39 të ligjit të auditimit, nga ana IEKA-s në Nentor 2023 u punësuan dy inspektore të kontrollit të cilësisë, në mënyrë për krijuar një strukturë e cila po punon me intensitet për të rritur nivelin e aftësive të tyre në drejtim të kontrollit të cilësisë dhe krijimin e një manuali për kontrollin e cilësisë që i përshkruan ndryshimeve të reja në SNMC1 dhe SNMC2.

Për këtë arsye nga ana e Inspektoreve të Kontrollit të Cilësisë po punohet ngritjen profesionale duke marrë pjesë në shumë seminare dhe takime me specialiste të kësaj fushe, siç janë ato të programit të Bankes Botërore për Kontrollin e Cilësisë, kjo në bashkëpunim edhe me BMP, në takime të shpeshta me kontrolloret e cilësisë së organizatave simotra të Kosovës, Malajzisë, etj.

Objektivi është të krijohet një sistem efikas të kontrollit të cilësisë dhe në baze të performancës së krijuar do të paraqiten të gjitha argumentat përpara BMP në mënyrë që të garantojmë realizimin me sukses të tij të këtij misioni dhe të bëjë të mundur që në baze të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes IEKAs dhe BMP të bëjë të mundur që ky kontroll për auditimet e njësive ekonomike, të cilat nuk janë me interes publik në përputhje me nenin 39 të ligjit të auditimit, të kryhen nga stafi i inspektoreve të Cilësisë së IEKA-s në koordinim me Drejtorin Ekzekutiv dhe Komitetin e Kontrollit të Cilësisë.

- Një ndër çështjet më të rëndësishme që ju kushtua prioritet gjatë vitit 2023 ishte prezantimi i një **dosje të plote të auditimit** që duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve të IEKA-s, Ky prezantim u krye në sezonin e parë të Kualifikimeve të Vijueshëm të mbajtur gjatë muajit Qershor 2023 nga z.Kondor Ceka dhe z.Klajdi Kadillari;
- komunikimi i informacioneve për anëtarët duke i pajisur ata me shumë udhëzime, guida dhe materiale të vlefshme për auditim. Në zhvillimin profesional të vijueshëm, vëmendja ju kushtua nevojave të anëtarëve në lidhje me zbatimin e standardeve teknike të fushës kontabël dhe të auditimit, të etikës profesionale, etj. Standardet ndërkombëtare të auditimit, të kontabilitetit e raportimit financiar përfshirë përmirësimet në kodin e etikës, praktika auditimi, raste të gjetjeve të kontrollit të cilësisë që nga pranimi i angazhimit /vazhdimi /raportimi, çështjet e aktualizimit të njohurive në fushën e tatimeve dhe taksave, legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave, Manuali i Doganës me raste praktike etj. u trajtuan gjerësisht gjatë dy sesioneve të kualifikimit të vijueshëm në muajin tetor dhe nëntor 2023.
- Për disa nga modulet profesionale sipas Kurrikulës së miratuar të Profesionit të Audituesve Ligjorë u bënë përmirësime bazuar në një analizë të detajuar të metodës së integruar të edukimit.

Është përkthyer teksti KAPLAN i ACCA për Modulin e Raportimit Financiar të Avancuar (pjesa II) i cili është zhvilluar me kandidatët e vitit të parë. (më parë kanë qenë përkthyer tekstet respektive të auditimit e dhënies së sigurisë në nivel të avancuar dhe menaxhimit të performancës në nivel të avancuar).

Veprimtaritë trajnuese të anëtarëve u plotësuan me botime të reja profesionale të IFAC-ut për të mbuluar zhvillimet e reja, përmirësimet në standardet e auditimit, standardet për shërbimet e rishikimit, të sigurive të tjera, të kontrollit të cilësisë, shërbimet e lidhura, etj.

Një vëmendje e veçantë, ndër të tjera i është kushtuar Standardit Ndërkombëtar të Auditimit

- SNA 540 (i rishikuar) “Auditimi i Çmuarjeve Kontabël dhe Informacionet Përkatëse Shpjeguese”, i cili hyn në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë më datë 15 Dhjetor 2019 dhe pas kësaj date. Në mbështetje të anëtarëve për t’i ndihmuar në përdorimin dhe zbatimin e këtij standardi, IEKA ka publikuar në faqen e ëeb materiale të ndryshme udhëzuese dhe informuese të marra nga IFAC. SNA 540 (i rishikuar) ka në objektivin e vetë përgjegjësitë e audituesit në lidhje me çmuarjet kontabël dhe informacionet përkatëse shpjeguese në auditimin e pasqyrave financiare.

Një nga objektivat kryesore të punës së IEKAs mbetet kontrolli i zbatimit të kërkesave të SNA- ve. Për këtë qëllim duhet të përdoren më mirë se deri më sot, instrumentet e kontrollit të cilësisë, pasi ato të na autorizohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe të hartohen e zbatohen rregulla të veçanta për kontrollin e zbatimit të parimeve etike e kërkesat e pavarësisë, duke i lidhur papajtueshmëritë kur ato janë të rëndësishme edhe me procedurat e investigimit dhe të disiplinës së brendshme të IEKAs.

Duke qenë se në vitin 2023, angazhimet e tjera zënë rreth 46.7% të totalit të angazhimeve të kryera nga audituesit ligjorë, kontrolli i cilësisë së punës së shërbimeve të tjera mbetet një nga objektivat që IEKA duhet të arrijë në periudhën në vijim.

IEKA do të vijojë të bëjë përpjekje që roli i saj të mbetet ai i njërit prej autoriteteve rregullatore kompetente të profesionit, me qëllim që të ketë rol e përgjegjësi në çështje të tilla si kontrolli i cilësisë, investigimi, edukimi i kandidatëve dhe anëtarëve, përgatitja e udhëzuesve dhe procedurave të punës profesionale, etj. Raportet midis IEKAs dhe BMP janë e do të jenë në evoluim të vazhdueshëm dhe do të kushtëzohen gjithmonë me zhvillimet që mund të ndodhin në mjedisin Europian dhe me hapat integruese që do të bëjë vendi ynë në vitet e ardhshme.

Nisur nga praktikat e shumë vendeve të BE-së dhe atyre aspirante, roli i Bordit të Mbikëqyrjes Publike në një të ardhme të afërt duhet fokusohet direkt dhe vetëm në kontrollin e cilësisë, të audituesve dhe auditimeve të entiteteve me interes publik, siç janë Bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimit dhe të ri- sigurimit, si dhe një numër ndërmarrjesh të mëdha, me pronësi shtetërore dhe/ose private, që janë përcaktuar nga qeveria si entitete me interes publik.

Në vitin 2023 IEKA ka përmirësuar procesin e edukimit dhe përkthimin e teksteve të ACCA(Kaplan Publishing) që janë përdorur si module të përgatitjes së profesionistëve në vendin tonë. Instituti filloi procesin e edukimit profesional të kandidatëve sipas kurrikulës së re të miratuar për profesionin e audituesit ligjor. Për herë të parë nisi në vitin 2019 trajnimi i kandidatëve të vitit të parë me modulën profesionale (niveli i avancuar) në lëndën **“Raportimi Financiar i Avancuar”**. Vazhdimi i trajnimit me këtë modul u realizua në vitin 2023. Gjatë 3 viteve të praktikës profesionale, kandidatët për auditues ligjorë do të trajnohen me modulet si vijon:

- Raportimi Financiar i Avancuar
- Tatime dhe taksa – Nivel i Avancuar
- Legjislacioni i Biznesit – Nivel i Avancuar
- Drejtimi i Performancës – Nivel i Avancuar
- Auditim & Dhënie Sigurie – Nivel i Avancuar
- Etika Profesionale

Ndryshimet që kanë pasuar miratimin e kurrikulës së plotë të audituesit ligjor dhe veçanërisht iniciimi i shkollës postmaster të IEKAs, tregojnë se ky proces është në rrugën e njëpërmirësimi të vazhdueshëm.

Versionet më të fundit të materialeve të ACCA- së u janë vënë në dispozicion kandidatëve për Auditues Ligjor që ndjekin praktikën profesionale. Aktualisht është përkthyer nga libri i ACCA “Raportimi financiar” (niveli i avancuar), moduli i parë dhe i dytë për trajnimet e kandidatëve për Auditues Ligjor, që përfshin tema të tilla si: aktivet, kurset e këmbimit, qiraja financiare, ngjarjet pas datës së bilancit, instrumentat financiare, kontabiliteti i grupit etj. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që kandidatët për Auditues Ligjor në Shqipëri të përgatiten në të njëjtën mënyrë si të gjithë kandidatët e tjerë në të gjithë botën. Megjithatë mbetet ende shumë për të bërë në drejtim të monitorimit të praktikës profesionale dhe garantimit të një udhëheqje profesionale dhe cilësore.

Lidhur me kualifikimin e vijueshëm të anëtarëve, Instituti ka treguar shumë kujdes në përzgjedhjen e temave të duhura dhe angazhimin e lektorëve të kualifikuar. Në kushtet e zbatimit të masave të rekomanduara nga Qeveria Shqiptare për ruajtjen e distancimit social, si dhe duke respektuar masat e sigurisë për kufizimin e transmetimit të COVID-19, mori një rëndësi të veçantë organizimi i trajnimeve online. Kjo formë trajnimi është e rekomanduar edhe nga IFAC dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, në të cilat IEKA është e anëtare me të drejta të plota.

Megjithë rolin e rëndësishëm të IEKAs dhe të anëtarëve të saj për përmirësimin e raportimit financiar në vendin tonë, ka nevojë për përmirësim në drejtim të cilësisë së shërbimeve profesionale, të respektimit të procedurave të parashikuara në standardet e auditimit, të raporteve të auditimit dhe të sigurive të tjera, respektimit të Kodit të Etikës, të rotacionit të audituesve pas përfundimit të periudhës kufi të përcaktuar nga ligji i auditimit, të vlerësimit të konflikteve të interesit nga dhënia e shërbimeve të tjera si kontabilitet, këshillime fiskale për të njëjtin klient auditimi, përdorimi i tarifave të ulëta në auditim, mosdeklarimi i misionëve dhe moslikuidimi në kohë i kuotave profesionale, etj.

Faqja e internetit të IEKAs vazhdon të pasurohet në mënyrë aktive me materiale të dobishme për audituesit ligjorë. Gjatë këtij viti është publikuar edhe Kodi i ri i Etikës dhe tools-ete Code, të cilat do t'ju vijnë në ndihmë anëtarëve të IEKAs gjatë përdorimit të Kodit të Etikës. Një faqe e re ëeb-i, e cila do të jetë më interaktive dhe profesionale, është përgatitur dhe do të lancohet së shpejti. Regjistri Publik i Audituesve Ligjor, aktualisht është lehtësisht i aksesueshëm për përdoruesit aktualë dhe potencial dhe është i publikuar në faqet e institucioneve të rëndësishme kombëtare si: QKB, Gjykatat, etj.

Gjatë vitit 2023, vazhduan marrëdhëniet institucionale të IEKAs me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik e të Sipërmarrjes, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Institutin e Kontabilistëve të Miratuar, Shoqatën e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, etj.

Zhvillime të reja dhe qendrueshmeri njohën edhe marrëdhëniet e IEKAs në sferën ndërkombëtare, me organizata të tilla si IFAC, FCM, FIDEF, EFAA, Banka Botërore, CFREP Reparis - Vienë, Varshave, Shkup, ACCA, FEE, etj., duke u bere pjesmarrese ne Kongresin e IFAC ne Viene, ku u zgjodh CEO i ri i IFAC z.Lee White, ne FCM ku u zgjodh presidenti i ri i saj z.

Rritja e rolit dhe përmirësimi i reputacionit të Audituesit Ligjor dhe të organizatës sonë profesionale mund të bëhet realitet vetëm nëse ne do të kombinojmë më mirë se deri më sot rolin e organeve të zgjedhura me ato ekzekutive, nëse mendojmë seriozisht për investime afatgjata në burimet njerëzore, me synim fuqizimin administratës ekzekutive, në funksion të përmirësimit të qeverisjes së Institutit dhe rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë. Vetëm në këtë mënyrë nga njëra anë interesi publik trajtohet me prioritet dhe nga ana tjetër mbrohet nderi dhe reputacioni i individit.

Për vitin 2023, përbërja e anëtarëve të organizatës profesionale vijon të jetë si më poshtë:

- Gjatë vitit 2023 janë regjistruar dhe c'regjistruar si Auditues Ligjor për të ushtruar profesionin, 240 AL, nga të cilët 129 femra dhe 111 meshkuj;
- AL jo praktikues 176 anetare, 124 femra dhe 52 meshkuj.

Sipas nenit 32, pika 2 e Ligjit Nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, Audituesi Ligjor mund ta ushtrojë profesionin:

- në mënyrë individuale;
- si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese;
- i punësuar te një tjetër auditues ligjor i regjistruar.

Në objektin e veprimtarisë së këtyre shoqërive përfshihet auditimi ligjor i pasqyrave financiare të njësive ekonomike, institucioneve financiare bankare dhe jo bankare, sipas kërkesave të ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” (i ndryshuar). Kryesisht në secilën nga këto shoqëri ushtrojnë profesionin 2 deri në 3 Auditues

Ligjorë, të regjistruar në Regjistrin Publik të IEKAs. Audituesit Ligjorë (AL) janë të përqëndruar kryesisht në Tiranë, por duhet theksuar se në Regjistrin Publik të IEKAs janë të regjistruar profesionistë nga të gjitha trevat e Shqipërisë. Shpërndarja gjeografike e audituesve ligjorë, ilustruhet në tablën dhe grafikun në vijim

Numri i kandidatëve në praktikën profesionale për vitin 2023 është: Viti I - 14 kandidatë, Viti II – 14 kandidatë dhe Viti III – 22 kandidatë;

Regjistrimi i kandidatëve për hyrjen në praktikën profesionale u krye në periudhën nga data 1 deri 15 Nëntor 2023 në zbatim të Rregullores së Edukimit. Duke filluar nga viti 2017 kandidatët zhvillojnë praktikën profesionale nën udhëheqjen e Audituesit Ligjor **vetëm me marrëveshje dhe kontratë pune me kohë të plotë 3 vjeçare**. Kërkesa për pranimet në praktikën profesionale gjatë ketyre viteve ka patur tendencë në ulje.

Në zbatim të programit të punës për vitin 2023, i cili është miratuar nga Këshilli Drejtues i IEKAs, si edukimi i kandidatëve edhe kualifikimi i vijueshëm është kryer nga lektorë profesionistë me eksperiencë, duke synuar rritjen e cilësisë së kualifikimit të anëtarëve dhe kandidatëve tanë. Programi i kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve është hartuar duke marrë në konsideratë edhe propozimet e ndryshme nga anëtarët e IEKAs. Këshilli Drejtues në bashkëpunim me Stafin Ekzekutiv kanë organizuar gjatë vitit 2023, dy sesione të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të IEKAs.

Gjatë vitit 2023 **Komiteti i Edukimit dhe Zhvillimit të Vijueshëm Profesional** ka kryer funksionin e tij me përbërjen më poshtë:

- | | |
|----------------------|---------|
| - Edrian Meslani | Kryetar |
| - Armand Hasko | Anëtar |
| - Eglina Pjeternikaj | Anëtar |
| - Ingegerta Bebi | Anëtar |
| - Jonid Lamllari | Anëtar |

Kualifikimi i Vijueshëm i Anëtarëve të IEKA-s

Referuar Ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” (të ndryshuar), *Audituesit ligjorë i nënshtrohen kualifikimit të vijueshëm profesional, i cili është i detyrueshëm dhe zgjat, të paktën, 40 orë.*

Këshilli Drejtues ka vendosur që trajnimet e anëtarëve të bëhen online nëpërmjet aplikacionit ZOOM Webinar. Në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues, stafi ekzekutiv ka testuar përdorimin e platformës së komunikimit online të aplikacionit “ZOOM Webinar” duke bërë të mundur zhvillimin me sukses të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve në dy sesione. Ky aplikacion ka qenë lehtësisht i përdorshëm dhe i aksesueshëm për anëtarët dhe ka mundur një kapacitet më të madh të pjesëmarrësve.

Sipas Programit të Kualifikimit të Vijueshëm – Viti 2023 miratuar me Vendim të KDs së IEKAs sipas seksioneve janë kryer këto tema:

1. Sesioni i parë 11 janar 2023 (2 orë)
 - a. Planifikimi i Auditimit të SME;
2. Sesioni i dytë 13, 14, 15 qershor 2023 (18 orë)
 - a. Programi EP Auditing (Shembulli i një dosje auditimi të plotë);
 - b. Standardet Ndërkombëtare të Auditimi 315;
 - c. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit 220;
 - d. Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë 1;
 - e. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit 500 Evidenca e Auditimit;
3. Sesioni i tretë 19, 20, 21 dhe 22 dhjetor 2023 (20 orë)
 - Tatimi mbi të ardhurat | Tatimi mbi fitimin | Diskutime mbi projektligjin “Për tatimin mbi të Ardhurat”
 - ISA 220 (Revised) Quality management for an audit of financial statements; ISQM 1 Quality management for firms that perform audits or reviews of financial statements, or other assurance related services engagements; ISQM 2 Engagement quality reviews;
 - Ndryshimet Ligjore të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të Terrorizmit” i ndryshuar | Vlerësimi i Riskut | Tipologji, etj,
 - Sesioni ekstra online ZOOM miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. , datë 2023 (16 orë, shtesë për vitin 2023)

Trajnimi i Kandidatëve të IEKAs

Gjatë kryerjes së praktikës profesionale kandidatët ndjekin edukimin profesional të avancuar që realizohet me pjesëmarrjen në trajnime, leksione, seminare dhe testimet përkatëse për njohuritë e aftësitë profesionale, sipas moduleve që përmban programi.

Programi i studimeve post master për marrjen e titullit “Auditues Ligjor” realizohet nga dhe pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) me kohëzgjatje normale jo më pak se 3 vite kalendarike.

Disiplinat dhe veprimtaritë e tjera formuese, që zhvillohen në këtë program studimi gjatë 3 viteve të praktikës profesionale, përfshijnë modulet profesionale të një niveli të avancuar, si më poshtë:

- Moduli Raportimi Financiar i Avancuar;
- Moduli Taksimi i Avancuar;
- Moduli Legjislacioni i Biznesit i Avancuar;
- Moduli Auditim dhe Dhënie Sigurie i Avancuar
- Moduli Drejtimi i Performancës i Avancuar
- Moduli Etika Profesionale

Në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues të IEKAs Nr 37 datë 20.09.2017 për miratimin e Kurikulës së Profesionit të Audituesit Ligjor me konsulencën e projektit të BB, në muajin Korrik 2019 nisi për herë të parë kualifikimi i 43 kandidatëve të vitit të parë 2019 me modulet profesionale sipas Kurikulës së Profesionit të AL (Niveli Profesional i avancuar), të cilat kryhen vetëm nga organizata profesionale e Audituesve Ligjorë.

Trajnimet janë kryer online nëpërmjet aplikacionit ZOOM Webinar. Përpara zhvillimit të trajnimit, lektorët dhe kandidatët kanë marrë instruksionet e nevojshme nga sektori i edukimit.

INFORMATA TË PËRGJITSHME:

Sektori i Edukimit së bashku me Komitetin e Edukimit dhe Kualifikimit të Vijuëshëm Profesional përgjatë gjashtë muajit të parë 2023 ka kryer në total 13 mbledhje në të cilën në total janë marrë 93 vendime kundrejt programit postmaster për vitin 2023, kërkesave të ndryshme lidhur nga kandidatët ose personave të tretë lidhur me përfshatimet nga praktika profesionale si dhe trajnimit të kualifikimit të vijueshëm profesional, në të cilën Sektori i Edukimit ka ndjekur direktivat prej vendimeve të Komitetit të Edukimit, Drejtorit Ekzekutiv dhe Këshillit Drejtues.

INFORMATA TË DETAJUARA:

1. Sektori i Edukimit në Janar të vitit 2023 ka asistuar në detyrat si më poshtë:

Kërkesën për përjashtim nga praktika profesionale si mbajtës të titullit të ACCA të z. Erol Kamberi duke qenë se i ka plotësuar kushtet për përjashtimin nga praktika profesionale.

Në vijim, pasi u miratua testimi hyrës nga Komiteti i Edukimit për kandidatët e vitit të I 2023 të programit postmaster për Auditues Ligjor, më datë 31 Janar 2023 u zhvillua testimi hyrës në orën 12.00 në të cilën morën pjesë 15 kandidatë dhe 14 prej tyre rezultuan fitues.

2. U propozua trajnimi shtesë online për kualifikimin e vijueshëm profesional për vitin 2022 ku u realizuan me anë të platformës së ZOOM 16 orë shtesë për vitin 2022 e cila u realizua më datë 21 Shkurt – 24 Shkurt 2023 për Audituesit Ligjorë të cilët nuk kishin përmbushur detyrimet.

3. Në këtë sesion shtesë të kualifikimit të vijueshëm profesional për vitin 2022 morën pjesë anëtarët aktivë dhe pasivë të cilët nuk kishin përmbushur detyrimet për vitin 2022.

- Më datë 21 Shkurt 2023 u realizua tema “Planifikimi i Auditimit” në të cilën morën pjesë 32 anëtarë aktivë dhe 38 anëtarë pasivë;
- Më datë 22 Shkurt 2023 u realizua tema “Programi EP Auditing” në të cilën morën pjesë 23 anëtarë aktivë dhe 35 anëtarë pasivë;
- Më datë 23 Shkurt 2023 u realizua tema “Tatimi mbi të ardhurat” në të cilën morën pjesë 14 anëtarë aktivë dhe 29 anëtarë pasivë;
- Më datë 23 Shkurt 2023 u realizua tema “SNA” në të cilën morën pjesë 12 anëtarë aktivë dhe 24 anëtarë pasivë;

Më tej, për vitin 2022, Komiteti vendosi që të kryhej rishikimi i të gjitha testeve për kandidatët me 44 pikë brenda muajit Janar 2023.

4. Në vijim, përgjatë muajit Janar, Sektori i Edukimit ka asistuar në Komitetin e Edukimit lidhur me:
- Miratimin e kalendarit të programit të studimeve post master për marrjen e titullit profesional “Audites Ligjor” për vitin 2023, në të cilën modulet dhe programi të jetë i njëjtë me vitin 2022, përpos testeve të ndërmjetme të cilat me vendim janë propozuar të hiqen dhe të ketë vetëm një testim përfundimtar dhe një ritestim. Në këtë vendim nuk bën pjesë raportimi financiar i avancuar pasi është modul i ngarkuar dhe është i ndarë në dy pjesë.
 - Në vijim të mbledhjes është diskutuar lidhur dhe me kërkesën për përjashtimet nga praktika profesionale për kandidatët me mbi 15 vite eksperiencë profesionale, përkatësisht për zj. Adriana Kotherja.

Kalendari lidhur me Programin Postmaster për Audites Ligjor për vitin 2023 është zhvilluar si më poshtë:

Nr.	Moduli	Data e zhvillimit të modulit	Viti i kandidatëve	Data e Testimit	Data e Ritestimit
0	Testim Hyrës	-	Viti I 2023	31.01.2023	-
1	Standardet Kombëtare e Kontabilitetit (Pjesë hyrëse e AFR-së)	03.04.2023 – 07.04.2023	Viti i I 2023	25.04.2023 (SKK + AFR 1)	-
2	Raportimi Financiar i Avancuar	11.04.2023 – 05.05.2023	Viti i I 2023	17.05.2023 (AFR 2)	(SKK + AFR 1 + AFR 2) 16.06.2023
3	Taksim i Avancuar	11.09.2023 – 22.09.2023	Viti i I 2023	06.10.2023	07.11.2023
4	Legjislacion Biznesi i Avancuar	09.05.2023 – 22.05.2023	Viti i II-të 2023	01.06.2023	03.07.2023
5	Drejtim Performance e Avancuar	26.09.2023 – 03.10.2023	Viti i II-të 2023	11.10.2023	13.11.2023
6	Auditim dhe Dhënie Sigurie e Avancuar	24.05.2023 – 01.06.2023	Viti i III-të 2023	07.06.2023	05.07.2023
7	Etika Profesionale	07.06.2023 – 14.06.2023	Viti i III-të 2023	21.06.2023	12.07.2023

5. Përsa i përket muajit Shkurt, Sektori i Edukimit është angazhuar së bashku me Komisionin që u miratua nga Komiteti i Edukimit përkatësisht z. Edrian Meslani, znj. Eglina Pjetërnikaj dhe z. Jonid Lamllari lidhur me temat për punimet profesionale të cilët kandidatët patën dorëzuar për pjesëmarrjen në prezantimet e punimeve profesionale të kandidatëve të vitit të tretë 2022 si dhe për kandidatët e vitit të tretë 2020, 2021 të cilët nuk e kanë mbrojtur në vitin përkatës dhe e prezantuan së bashku me kandidatët e vitit të tretë 2022.

Në vazhdim, sektori i edukimit ka asistuar dhe është ngarkuar për zbatimin e vendimit të Komitetit të Edukimit lidhur me miratimin e rëtestimeve/ rikorrigjimeve për modulet e mbetura të tjera të vitit 2022 përkatësisht:

- Rëtestim i Raportimit Financiar i Avancuar;
 - Rëtestim Legjislacion Biznesi i Avancuar;
 - Rëtestim Drejtim Performance e Avancuar;
 - Rëtestim i Auditim dhe Dhënie Sigurie e Avancuar.
6. Gjatë muajit Mars 2023 u miratuan përfundimi i praktikës profesionale dhe programit postmaster për kandidatët e vitit të tretë 2022 të cilët i kanë mbyllur të gjitha detyrimet ndaj IEKAs.
- U shqyrtua kërkesa e z. Julian Saraci për përjashtimin nga praktika profesionale si mbajtës i titullit ACCA për të cilin u konstatua se i plotësonte të gjitha kriteret lidhur me përjashtimin nga praktika profesionale.

- U shqyrtuan dhe kërkesa të tjera lidhur me përjashtimin nga praktika profesionale për aplikantët të cilët kanë 15 vite përvojë në ushtrimin e profesionit përkatësisht për:
 - Zj. Adriana Kotherja;
 - Zj. Elisabeta Katiaj;
 - Z. Gledis Shehu;
 - Z. Gëzim Kallajxhi;
 - Zj. Roven Balliu;
 - Z. Edvin Xhango;
 - Zj. Lorena Cakërri;
 - Z. Armando Cadri;
 - Z. Kledi Hasani.

7. Përgjatë muajit Prill 2023 Sektori i Edukimit ka asistuar duke propozuar për Komitetin e Edukimit lidhur me programin postmaster për vitin 2023 për të cilin u vendos të kryhet testim i ndërmjetëm vetëm për Raportimin Financiar të Avancuar për shkak se është i ndarë në dy pjesë. Për sa i përket moduleve të tjera: (Taksim i Avancuar; Legjislacion Biznesi i Avancuar; Drejtim Performance e Avancuar; Auditim dhe Dhënie Sigurie e Avancuar; Etika Profesionale.), u vendos të kryhet vetëm testim përfundimtar, pra pa të ndërmjetëm.

Gjithashtu, një tjetër çështje qëndron lidhur me propozimin në Këshillin Drejtues për pajsijen me Certificate në fund të vitit për AL të cilët kanë ndjekur kualifikimin e vijueshëm profesional.

8. Përgjatë muajit Maj 2023, Sektori i Edukimit ka asistuar në programin postmaster për AL për vitin 2023, komunikimin me lektorët lidhur me modulet e ndjekura për 6-mujorin e parë për këtë vit si dhe organizimin e kryerjes së trajnimeve për kandidatët pjesëmarrës të programit postmaster dhe praktikës profesionale.

- Në vijim sektori i edukimit duke ndjekur direktivat nga Komiteti i Edukimit, Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, asistoi lidhur me Sesionin e I të Kualifikimit të Vijueshëm Profesional për vitin 2023, i cili u mbajt më 26 deri më 30 Qershor ku në total u zhvilluan 20 orë. Anëtarët Aktiv e zhvilluan fizikisht, ndërsa anëtarët pasiv online në platformën e zoom pro sipas kalendarit më poshtë:

Kalendari për Kualifikimin e Vijueshëm Profesional, Sesion I 2023

Nr.	Tema	Data	AL Aktiv	Lektor	Ora
1	Dosje e Auditimit (6 orë);	26 Qershor 2023	Fizikisht Tirana International Hotel Salla Akernia	Grup Lektorësh	09.00 – 12.00 1 ore pushim 13.00 – 16.00
2	Dosje e Auditimit (6 orë);	27 Qershor 2023	Fizikisht Tirana International Hotel Salla Akernia	Grup Lektorësh	09.00 – 12.00 1 ore pushim 13.00 – 16.00
3	Dosje e Auditimit (2 orë)	29 Qershor 2023	Fizikisht Tirana International Hotel Salla Akernia	Grup Lektorësh	09.00 – 11.00

RAPORT VJETOR 2023

4	Aftësitë në menaxhim dhe komunikim (2 orë);	30 Qershor 2023	Fizikisht Tirana International Hotel Salla Akernia	Anila Kava	09.00 – 11.00
5	Koncepte bazë të ndikimit të sistemit të IT-së në auditim dhe Siguria Kibernetike (4 orë);	30 Qershor 2023	Fizikisht Tirana International Hotel Salla Balsha	Mateo Gosnishti	11.30 – 15.30

Në sesionin e I të Kualifikimit të Vijueshëm Profesional për vitin 2023 u zhvilluan në total 20 orë.

- Numri i anëtarëve aktivë e përditësuar është 237 anëtarë në të cilën vetëm 6 prej tyre rezultojnë me 0 orë, pra nuk kanë marrë pjesë në trajnim;
- Numri i anëtarëve pasivë e përditësuar është 161 anëtarë në të cilën vetëm 69 prej tyre rezultojnë me 0 orë, pra nuk kanë marrë pjesë në trajnim;

9. Përgjatë muajit Qershor 2023, sektori i edukimit ka asistuar në mbledhjen e Komitetit të Edukimit në të cilën:
 - U miratuan testimet e kryera për programin postmaster për AL për vitin 2023.
 - Në vijim gjithashtu, u diskutua dhe për kërkesën e zj. Dorina Lulushi si mbajtëse e titullit ACCA dhe z. Indrit Ago, si dhe për aplikantë të tjerë z. Flladion prenga dhe zj. Elida Sallamani të cilët kanë kërkuar përjashtim nga praktika profesionale si ushtrues të profesionit për 15 vite.
10. Sektori i Edukimit në Korrik të vitit 2023 ka asistuar në përkatësisht në testimet lidhur me programin postmaster.

Sikurse është paraqitur në raportin e parë të gjashtë mujorit, modulet të cilat janë zhvilluar janë:

- Raportimi Financiar i Avancuar për kandidatët e vitit të parë 2023;
- Legjislacioni i Biznesit të Avancuar për kandidatët e vitit të dytë 2023;
- Auditim dhe dhënie sigurie e avancuar për kandidatët e vitit të tretë 2023;
- Etika Profesionale për kandidatët e vitit të tretë 2023;

Testimet në të cilën Sektori i Edukimit ka asistuar për muajin Korrik janë:

1. Ritestimi i modulit të Auditim dhe Dhënie Sigurie e Avancuar për kandidatët e vitit të III-të 2023 zhvilluar më datë 07 Korrik 2023;
2. Ritestimi i modulit të Etikës Profesionale për kandidatët e vitit të III-të 2023 zhvilluar më datë 13 Korrik 2023.

Në vijim të rezultateve të korigjimit dhe në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues **nr. 43, datë 06.09.2022** "Për miratimin e tarifës për rishikim/rikorigjim provimi është në vlerën 10,000 leke", disa prej kandidatëve kanë kryer kërkesë për rikorigjim testimi në të cilën sektori i edukimit i ka asistuar si kërkesa së bashku me drejtorin ekzekutiv dhe komitetin e edukimit dhe kualifikimit të vijueshëm profesional. Gjithashtu, Sektori i Edukimit në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit Drejtues për muajin Korrik dhe Gusht 2023 ka asistuar në kërkime shkencore dhe materiale informuese të cilat i ka shpërndarë me anë të email-it anëtarëve të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Këto materiale kanë qenë të lidhura me:

- Projekt-ligjin për "Taksën mbi pasurinë e paluejtshme";
- Ligji nr. 62/2023 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit", të ndryshuar;
- Artikullin "Fraud is on the rise: Step up to the challenge" në gjuhën angleze nga Institututi i

Autorizuar i Auditorëve të Brendshëm (Chartered Institute of Internal Auditors); Personat e ekskpozuar politikisht;

- Cilësia e auditimit në gjuhën angleze;
- Etj.

11. Në vijim, gjatë muajit Gusht 2023, është kryer mbledhja e Komitetit të Edukimit më datë 03.08.2023 në të cilën sektori i edukimit ka asistuar në këtë mbledhje për çështje të lidhura me:

- Miratimin e pjesëmarrjes së anëtarëve (aktivë dhe pasivë) në kualifikimin e vijueshëm profesional sesioni I për vitin 2023.
- Miratimin e rikorrigjimit të testimit përfundimtar të modulit të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë të zj. Helga Aliaj, kandidate në vitin e III-të 2023 dhe vendimmarrje për miratimin e testimit të Etikës Profesionale për kandidatët e vitit të III-të 2023.
- Miratimin e ritestimit të Legjislacionit të Biznesit të Avancuar për kandidatët e vitit të II-të 2023, si dhe miratimin e rikorrigjimit të testimit të Etikës Profesionale për kandidatët e vitit të III-të 2023 për z. Valentin Ndoci, zj. Helga Aliaj, zj. Marjola Mamullari, zj. Difrida delibashi, z. Dritan Hoxha dhe zj. Regi Goga.
- Miratimin e kërkesës së z. Gerond Begolli lidhur me organizimin e provimit për mospërmbushjen e orëve të kualifikimit të vijueshëm profesional për vitin 2021 dhe të znj. Erinda Xhaferraj mospërmbushjen e orëve të kualifikimit të vijueshëm profesional për sesionin e II-të të vitit 2021 dhe për vitin 2022.
- Diskutim dhe vendimmarrje për kërkesa të kandidatëve të vitit të III-të 2023 lidhur dhënien e mundësisë së përcaktimit të një date tjetër lidhur me ritestimin e modulit të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë së Avancuar dhe ritestimit të modulit të Etikës Profesionale **në të cilën ende nuk është marrë një vendim mbi këtë çështje.**
- Miratimin e ritestimit të modulit të Auditimit dhe Dhënie Sigurie e Avancuar për kandidatët e vitit të III-të 2023; Miratimin e ritestimit të Etikës Profesionale për kandidatët e vitit të III-të 2023.
- Diskutim dhe vendimmarrje lidhur me kërkesën e zj. Evis Duhaxhiu për përjashtim nga praktika profesionale për individët me 15 vite në ushtrimin e profesionit.
- Si dhe çështje të tjera.

Në këtë mbledhje Komiteti i Edukimit ka marrë 9 vendime lidhur me çështjet e mësipërme, në të cilën sektori i edukimit ka asistuar në mbledhjen e mësipërme dhe në përpilimin e vendimeve përkatëse.

12. Gjatë muajit Shtator 2023, sektori i edukimit përsëri ka asistuar në mbledhjen e kryer të Komitetit të edukimit dhe kualifikimit të vijueshëm profesional më datë 20.09.2023 me çështje të lidhura me:

- Miratimin e rikorrigjimit të ritestimit të modulit të Auditimit dhe Dhënie Sigurie e Avancuar për kandidatët e vitit të III-të 2023.
- Miratimin e kalendarit të kualifikimit të vijueshëm profesional, sesioni II-të 2023.
- Miratimin e rezultateve të testimit lidhur me mospërmbushjen e orëve të kualifikimit të vijueshëm profesional për z. Gerond Begolli dhe zj. Erinda Xhaferraj.
- Diskutim dhe vendimmarrje për ndryshimin e vendimit nr. 26, datë 22.07.2022 për Propozimin për tarifë për rishikim dhe rikorrigjim për provimet e programit postmaster për AL, **në të cilën është diskutuar se përpos tarifës të vendoset një kufir mbi pikët për kandidatët të cilët kërkojnë rishikim dhe rikorrigjim të testimit përkatës, ku komiteti propozoi që kandidatët të cilët rezultojnë në testim me 40 pikë e sipër kanë të drejtën e kërimit të rishikimit dhe**

rikorrigjimit të tezës përkatëse.

- Çështje të tjera në të cilën u diskutua miratimi i kërkesës së z. Alfred Sefa lidhur me organizimin e provimit për mospërmbushjen e orëve të kualifikimit të vijueshëm profesional për vitin 2021.

Në këtë mbledhje të asistuar nga Sektori i Edukimit, Komiteti i Edukimit ka marrë 4 vendime lidhur me çështjet e mësipërme.

Sektori i Edukimit më 22 Shtator nën direktiva të Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe Drejtorit Ekzekutiv së bashku me Kryetarin e Edukimit njoftoi të gjithë Audituesit Ligjorë në mënyrë individuale me anë të email-it mbi totalin e orëve të gjithsecilit përsa i përket Sesionit të I 2023, në mënyrë që çdo Auditues Ligjor të jetë në dijeni se sa orë ka kryer në Kualifikimin e detyrueshëm profesional.

- Për sesionin e II-të të Kualifikimit të Vijueshëm Profesional për vitin 2023 temat të cilat u përzgjedhën dhe u zhvilluan janë:
 - Marreveshjet Tatimore (4 orë) – Fatmir Kazazi;
 - Ligji për tatimin mbi të ardhurat (4 orë) – Edvin Stefani;
 - Gjetjet e raportit të KC dhe rekomandimet (4 orë) – Erjola Vejzati
 - Raportimi i Qëndrueshmërisë dhe Audituesit Ligjor (4 orë) - Fatos Beqja;
 - Evolucionin e rolit të Audituesit Ligjor dhe Teknologjia (4 orë) – Mateo Gosnishti.
- TOTAL = 20 ORË
- Për Audituesit Ligjorë jo ushtrues të profesionit sikurse në Sesionin e I, dhe sesioni i II-të u zhvillua online në platformën e ZOOM.
- Përsa i përket AL ushtrues të profesionit u krye ndarja në katër grupe në bazë të nr. të licencës.

Si më poshtë gjendet kalendari i propozuar nga KEKV për sesionin e II-të të vitit 2023.

KALENDARI PËR KUALIFIKIMIN E VIJUESHËM PROFESIONAL, SESIONI I II-të, VITI 2023								
Data	Grup	Ora	Nr. AL	O	Aktive	Pas	Lektor	Tema
30 Tetor 2023	G I	9:00 - 13:00	60 AL	4	salla Marin Barleti 1	zoom	Fatmir Kazazi	Marvëshjet Tatimore
	G II	09:00 - 13:00	60 AL	4	salla Marin Barleti 2		Edvin Stefani	Ligji për Tatimin mbi të ardhurat
	G I	13:30 - 17:30	60 AL	4	salla Marin Barleti 1		Inspektor BMP	Gjetjet e raportit të Kontorillit të Cilësisë, Rekomandime
	G II	13:30 - 17:30	60 AL	4	salla Marin Barleti 2		Fatos Beqja	Raportimi i Qendrueshmërisë dhe Audituesit Ligjor
06 Nëntor 2023	G III	9:00 - 13:00	60 AL	4	salla Marin Barleti 1		Fatmir Kazazi	Marvëshjet Tatimore
	G IV	09:00 - 13:00	60 AL	4	salla Marin Barleti 2	zoom	Edvin Stefani	Ligji për Tatimin mbi të ardhurat
	G III	13:30 - 17:30	60 AL	4	salla Marin Barleti 1		Inspektor BMP	Gjetjet e raportit të Kontorillit të Cilësisë, Rekomandime
	G IV	13:30 - 17:30	60 AL	4	salla Marin Barleti 2		Fatos Beqja	Raportimi i Qendrueshmërisë dhe Audituesit Ligjor
20 Nëntor 2023	G I	9:00 - 13:00	60 AL	4	salla Marin Barleti 1		Edvin Stefani	Ligji për Tatimin mbi të ardhurat
	G II	09:00 - 13:00	60 AL	4	salla Marin Barleti 2	zoom	Inspektor BMP	Gjetjet e raportit të Kontorillit të Cilësisë, Rekomandime
	G I	13:30 - 17:30	60 AL	4	salla Marin Barleti 1		Fatos Beqja	Raportimi i Qendrueshmërisë dhe Audituesit Ligjor
	G II	13:30 - 17:30	60 AL	4	salla Marin Barleti 2		Fatmir Kazazi	Marvëshjet Tatimore
06 Nëntor 2023	G III	9:00 - 13:00	60 AL	4	salla Marin Barleti 1		Edvin Stefani	Ligji për Tatimin mbi të ardhurat
	G IV	09:00 - 13:00	60 AL	4	salla Marin Barleti 2		Inspektor BMP	Gjetjet e raportit të Kontorillit të Cilësisë, Rekomandime
	G III	13:30 - 17:30	60 AL	4	salla Marin Barleti 1	zoom	Fatos Beqja	Raportimi i Qendrueshmërisë dhe Audituesit Ligjor
	G IV	13:30 - 17:30	60 AL	4	salla Marin Barleti 2		Fatmir Kazazi	Marvëshjet Tatimore
07 Dhjetor 2023	240 AL	10:00 - 14:00	240 AL	4	Durrës	zoom	Mateo Gosnishti	Siguria Kibernetike në auditim dhe sistemi IT
TOTAL CPD SESIONI II				20				
* Ndarja e grupeve është sipas nr. të licencës								

13. Në muajin Tetor 2023, sektori i Edukimit ka njoftuar kandidatët e vitit të III-të të programit postmaster për AL për dorëzimin e projekt – temave lidhur me punimet profesionale.

14. Përsa i përket fundit të Muajit të Tetorit dhe muajin e Nëntorit, sektori i Edukimit ka asistuar në Kualifikimin e Vijueshëm Profesional të sesionit të II-të, lidhur me mbarëvajtjen e listëprezencës së AL. (fizikisht për AL aktivë dhe online për AL pasivë).

15. Gjatë muajit Dhjetor 2023 sektori i edukimit ka kryer disa detyra dhe ka asistuar dhe në mbledhjen e KEKV-së lidhur me:

- Miratimin e testimit dhe ritestimit të modulit Taksimit të Avancuar për kandidatet e vitit të I 2023.
- Miratimin e testimit dhe ritestimit të modulit të Drejtim Performance të Avancuar për kandidatet e vitit të II-te 2023.
- Shqyrtimin dhe skanimin e dokumentave për përjashtimin nga praktika profesionale me përvojë 15 vite për zj. Ermira Hajrullahi.
- Shqyrtimin dhe skanimin e dokumentave për përjashtimin nga praktika profesionale si mbajtëse e titullit ACCA për zj. Arlinda Martinaj.
- Shqyrtimin dhe skanimin e dokumentave për përjashtimin nga praktika profesionale si mbajtëse e titullit ACCA për zj. Albana Caushi.
- Gjatë mbledhjes së KEKV-së u diskutua dhe u miratua Komisioni për prezantimin e punimeve profesionale në të cilën KEKV vendosi :
 1. Edrian Meslani;
 2. Eglina Pjetërnikaj;
 3. Armand Hasko.

Prezantimet e temave profesionale u zhvilluan në datën 18 dhe 19 Dhjetor 2023.

- Në këtë mbledhje gjithashtu u miratuan regjistrimet e kandidatëve të Programit Postmaster për vitin 2024. Numri i kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pranim në praktikën profesionale, programin postmaster për AL për vitin 2024 është 24 kandidatë për të cilën data e Testimit Hyrës është më 15 Janar 2024.
- Në vijim të Muajit Dhjetor dhe gjatë mbledhjes së fundit të KEKV-së, sektori i Edukimit asistoi lidhur me përpilimet e vendimeve mbi:
 - Miratimin e prezantimit të temave të punimeve profesionale për kandidatët e vitit të III-të të programit postmaster për AL.
 - Në vijim sektori i Edukimit ka asistuar dhe lidhur me shqyrtimin dhe skanimin e dokumentave për përjashtimin nga praktika profesionale me përvojë 15 vite për zj. Rozalba Bujupi.
 - U diskutua dhe u mor vendim në KEKV për njohjen e orëve të çertifikuara nga organizata e ACCA për zj. Desara Liko, Alba Paparisto, Dorian Petro dhe z. Amaraldo Hasani. (Bazuar në vendimin nr 12, datë 25.01.2023 "*Për njohjen e orëve të trajnimeve të çertifikuara nga organizata të tjera si orë të kualifikimit të vijueshëm profesional*").
 - KEKV së fundmi miratoi dhe listën pjesëmarrëse për sesionin e I dhe të II-të të Kualifikimit të

Vijueshëm Profesional për vitin 2023.

PËRFUNDIME

Në përfundim të Raportit vjetor, për sa më sipër gjenden të detajuara çështjet që Sektori i Edukimit ka asistuar në bashkëpunim me Komitetin e Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm Profesional, së bashku me Drejtorin Ekzekutiv dhe Kryetarin e Këshillit Drejtues për të cilën cdo direktivë, vendim është zbatuar dhe përfunduar në kohën e duhur, bazuar dhe në rregulloret përkatëse: *“Rregullores së Edukimit dhe Zhvillimit të Vijueshëm Profesional” dhe “ Rregulloren për realizimin e moduleve të përgatitjes profesionale, në kuadër të programit të edukimit të kandidatëve për Auditues Ligjor, pranë IEKAs” si dhe Ligjin 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar”.*

Gjithashtu, një aspekt tjetër i prekur nga sektori i Edukimit është dhe marketing-u me anë të krijimit dhe mbarëvotjes së faqes zyrtare të IEKAs në LinkedIn duke kryer cdo postim të aprovuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe Kryetari i Këshillit Drejtues duke e rritur audiencën e LinkedIn aktualisht 4797 ndjekës gjë e cila ofron rritjen e vizibilitetit të organizatës nga persona të tjerë. *(audiencia është e përbërë nga profesionistë të ndryshëm, në të cilën shumica janë AL ose në fushën e financës si dhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare)*

Përsa i përket vazhdimësisë së punës parashikohet që për vitin 2024 Sektori i Edukimit të kryejë këto detyra:

1. Të propozojë në KEKV kalendarin për programin postmaster për vitin 2024;
2. Të asistojë në sesionet e Kualifikimit të Vijueshëm Profesional për vitin 2024;
3. Të propozojë dhe asistojë në mbledhjet e Komitetit të Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm Profesional për vitin 2024;
4. Të ndjekë cdo direktivë dhe vendim të Këshillit Drejtues, KEKV dhe Drejtorit Ekzekutiv për të cilën janë të parashikuara në statutin e IEKAs dhe Rregulloret përkatëse të Edukimit.
5. Çështje të tjera si dhe kërkesa për vërtetime të ndryshme lidhur nga kandidatët ose personave të tretë si dhe vërtetime mbi orët e trajnimit të kualifikimit të vijueshëm profesional.

Sipas kalendarit të miratuar nga Këshilli Drejtues, për kandidatët e **vitit të parë** u realizua trajnimi sipas Moduleve më poshtë:

6. "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit" e realizuar me date 04 - 08 Korrik 2023 ne platformen e ZOOM; "Raportimi Financiar Pjesa e I", e realizuar me date 07 - 14 Shtator 2023 ne platformen e ZOOM; "Raportimi Financiar i Avancuar, pjesa e II", e realizuar me date 15 - 24 Shtator 2023, ne platformen e ZOOM.
7. "Taksimi i Avancuar", e realizuar me date 26 Shtator - 12 Tetor 2023, ne platformen e ZOOM.

Sipas kalendarit të miratuar nga Këshilli Drejtues, për kandidatët e **vitit të dytë** u realizua trajnimi sipas Moduleve më poshtë:

- "Taksim i Avancuar" (se bashku me vitin e I, pasi ne vitin 2021 nuk e kishin realizuar), e realizuar me date 26 Shtator - 12 Tetor 2023, ne platformen e ZOOM.
- "Legjislacion Biznesi i Avancuar", e realizuar me date 13 - 31 Tetor 2023, fizikisht prane ambinateve te IEKAs.
- "Drejtme Performance te Avancuar", e realizuar me date 01 - 12 Nentor 2023, fizikisht prane ambienteve te IEKAs.

Sipas kalendarit të miratuar nga Këshilli Drejtues, për kandidatët e **vitet të tretë** u realizua trajnimi sipas Moduleve më poshtë:

- "Drejtme Performance te Avancuar", e realizuar me date 01 - 12 Nentor 2023, fizikisht prane ambienteve te IEKAs.
- "Auditim dhe Dhenie Sigurie e Avancuar", e realizuar me date 17 Nentor - 02 Dhjetor 2023, fizikisht prane ambienteve te IEKAs.
- "Etika Profesionale", e realizuar me date 12 - 22 Dhjetor 2023, fizikisht prane ambienteve te IEKAs.

Frekuentimi i leksioneve të moduleve profesionale është i detyrueshëm në masën 75%, ndërsa frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%. Nga platforma janë gjeneruar raporte të ndryshme përfshirë dhe pjesëmarrjen në leksione dhe seminare.

Për sa i përket zhvillimit të trajnimit online me Zoom, lektorët dhe kandidatët kanë dhënë përgjithësisht feedback pozitiv. Lektorët e kanë zhvilluar trajnimin pothuajse si në kushte kualifikimi fizik, sigurisht duke i mbajtur të aktivizuar kandidatët me pyetje dhe përgjigje.

Megjithatë është konkluduar se zhvillimi i trajnimit me praninë fizike, ka efektivitet më të lartë në ndjekjen e trajnimit dhe përvetësimin e njohurive të marra.

Aplikacioni Google Classroom është përdorur me efektivitet për zhvillimin e seminarit. Në këtë aplikacion janë shkarkuar prezantimet e lektorëve, si dhe ushtrimet e kryera gjatë orëve të trajnimit.



Duhet të theksojmë se aplikacioni ZOOM i ka mbajtur të aktivizuar kandidatët për sa i përket zhvillimit të orëve të seminarit. Ushtrimet e zgjidhura nga kandidatët janë rishikuar nga Sektori i Edukimit, për të cilat kandidatët kanë marrë vlerësimin individual për zgjidhjen e ushtrimeve. Në përfundim të orëve të trajnimit, kandidatëve ju janë dërguar nëpërmjet këtij aplikacioni edhe ushtrime të tjera për të përvetësuar më mire njohuritë e marra gjatë leksionit, duke i lënë disa

ditë kohë (2-3) për zgjidhjen e tyre.

Për trajnimet e modulit “Taksimi i Avancuar” dhe “Legjislacioni i Biznesit i Avancuar” është përdorur aplikacioni ZOOM Webinar. Me anë të kësaj platforme u arrit të sigurohej edhe komunikimi me lektorin përkatës, pasi kandidatët mund të bënin pyetje nëpërmjet opsionit Q&A ose mund të ngrinin dorën nëpërmjet opsionit “Raise Hand”.

Gjatë vitit 2023 KEKV ka shqyrtuar dhe miratuar vendime lidhur me kandidatët që kryejnë praktikën profesionale, të grupuara si më poshtë:

- Vlerësimi i aplikimeve të personave që kanë shprehur interes për t’u pranuar si kandidatë në praktikën profesionale dhe miratimi i marrëveshjeve të nënshkruara me Auditues Ligjorë.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të kandidatëve si, ndërprerje të marrëveshjes së praktikës profesionale, kryerjen e orëve shtesë të praktikës profesionale, ndryshimin e drejtuesit të praktikës, etj.
- Vlerësimi i kryerjes nga kandidatët, të detyrimeve të parashikuara nga Ligji 10091 (i ndryshuar) dhe rregullorja e edukimit (trajnime, testime/ritestime dhe mbrojtja e punimit profesional për kandidatë në vitin e fundit të praktikës profesionale 2023.
- Vlerësimi i aplikimeve për përjashtime nga praktika profesionale për individë me 15 vite eksperiencë në fushën e kontabilitetit, auditimit, financës dhe legjislacionit dhe për përjashtime nga dhënia e disa provimeve për audituesit e huaj si mbajtës të titullit ACCA.

Mbi “Relacionin për Vazhdimin e Moduleve Profesionale sipas Kurrikulës së profesionit të Audituesve Ligjorë” përgatitur nga Njësia e Edukimit, dhe propozimi për KD mbi disa ndryshime në programin e moduleve profesionale;

Komiteti i Kontrollit të Cilësisë

Për të realizuar procesin e kontrollin të cilësisë, vendimin nr. 49 datë 27.09.2023 Këshilli Drejtues ka krijuar Komitetin e Kontrollit të Cilësisë, përbërja e të cilit është si më poshtë:

- Esmeralda Balluku Kryetar
- Doranin Agalliu Anëtar
- Ermir Veipi Anëtar
- Elida Miti Anëtar
- Gentian Tata Anëtar

Në ligjin e auditimit 10091 datë 05.03.2009 të ndryshuar me ligjin 47/2016 përcaktohet se, sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë përfshin dy hallka:

- Kontrollin e Cilësisë, që organizohet brenda shoqërisë së auditimit;
- Kontrollin e Cilësisë, që organizohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Kontrolli i cilësisë brenda firmës/kabinetit të auditimit duhet të garantohet përmes vendosjes së rregullave të brendshme të rishikimit për qëllime të kontrollit të cilësisë së angazhimeve, të cilat bazohen në SNKC1 dhe në udhëzimet përkatëse të përpunuara nga IEKA.

Procedura e kontrollit të cilësisë përcakton se kontrolli i cilësisë kryhet në bazë të një analize risku:

- të paktën një herë në çdo tre vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitet ekonomike me interes publik;
- një herë në çdo gjashtë vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitet e tjera ekonomike;
- një herë në dy vjet, derisa arrihet eksperiencia e kërkuar për audituesit ligjorë, me jo më shumë se pesë vjet përvojë pune në profesion.

Një nga pikat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Bordin e Mbikëqyrjes Publike që u nënshkrua në 11 shkurt 2021, është edhe delegimi i kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike që nuk janë me interes publik (JoEIP). Në këtë kuadër IEKA ka përmbushur detyrimin e saj sipas marrëveshjes, duke bërë rishikimin e Draft Rregullores nr. 7 të Kontrollit të Cilësisë datë 02.10.2018 “Për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor”, e ndryshuar, dërguar për mendim nga BMP.

Kontrolli i cilësisë për njësitet ekonomike jo me interes publik (Jo EIP) përfshin kontrollin e dosjevetë auditimit, duke bërë një vlerësim të pajtueshmërisë me standardet e auditimit, me kërkesat e etikës dhe të pavarësisë, një vlerësim të cilësisë dhe sasisë së burimeve të shpenzuara, të tarifave të auditimit të ngarkuara dhe një vlerësim të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë të shoqërisë audituese (kabinetit në rastin e personit fizik).

Në këtë aspekt IEKA ka marrë masat, duke argumentuar se plotëson kërkesat e kriterëve të ligjit 10091 datë 05.03.2009, të ndryshuar, dhe për realizimin e këtij procesi:

- ka reformuar Komitetin e Kontrollit të Cilësisë,
- ka një paketë të plotë të rregullave të kontrollit të cilësisë të cilat janë hartuar bazuar në eksperiencën e deritanishme dhe me ndihmën e konsulentit të projektit të Bankës Botërore,
- ka kërkuar që të angazhojë me kohë të plotë dy Inspektorë të Kontrollit të Cilësisë që plotësojnë kriteret e Ligjit 10091 datë 05.03.2009 (të ndryshuar).

Krahas reformimit të paketës së rregullave për kontrollin e cilësisë për JoEIP, IEKA po përgatit edhe:

- Një paketë të rregullave për kontrollin e cilësisë së shërbimeve të tjera.
- Organizimin e punës nga komiteti i kontrollit të cilësisë për verifikimin e zbatueshmërisë së standardeve profesionale dhe kërkesave ligjore nga Audituesit Ligjorë.

Materiali me rregulla për kontrollin e cilësisë së shërbimeve të kryera është marrë nga organizata profesionale FCM dhe është përkthyer nga IEKA.

Komiteti i Standardeve Profesionale dhe Etikës

Anëtarët e Komitetit të Standardeve Profesionale dhe Etikës, bazuar në nenin 21, të statutit të IEKAs, u miratuan me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 40 datë 06.09.2023.

Përbërja e Komitetit të Standardeve Profesionale:

3.Desara Liko
4.Artan Xhiani

Kryetar
Anëtar

5. Anjeza Maçolli	Anëtar
6. Eglina Pjetërnika	Anëtar
7. Ramiz Kamani	Anëtar

Fokusi kryesor i këtij komiteti është trajtimi i çështjeve dhe kërkesave për interpretim lidhur me zbatueshmërinë e standardeve profesionale dhe të kodit të etikës.

Për vitin 2023, është vijuar puna për përkthimin në gjuhën shqipe dhe përditësimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB).

Gjatë muajit Maj ka përfunduar përkthimi i Volumit III i Manualit të IAASB, icili i është shpërndarë anëtarëve të IEKAs nëpërmjet adresës së email si dhe është publikuar në faqen e web. Volumi III është shtesë e Deklaratave të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit e Sigurisë, të Standardeve mbi Kontrollin e Cilësisë, Auditimin, Rishikimin, Sigurive të tjera dhe Shërbimeve të Lidhura, si dhe Direktivën jo Detyruese të Praktikave Ndërkombëtare të Auditimit.

Ky volum përfshin dy nga temat që janë në fokus të IAASB:

16. Kuadri i IAASB për Cilësinë e Auditimit: Elementët kryesorë që krijojnë një mjedis për cilësinë e auditimit; dhe

17. Kuadri Ndërkombëtar për Angazhimet e Sigurisë.

Kodi Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël, botim i vitit 2023, i përkthyer në gjuhën shqipe është publikuar në faqen e Web si dhe është shpërndarë për anëtarët e IEKAs në adresat e tyre elektronike.

Kodi i ri është rishkruajtur tërësisht në një format të ri dhe ka një përmbajtje të përmirësuar, e cila bën më të lehtë referencimin në shumë çështje relevante dhe në përdorimin dhe zbatimin e tij të përshtatshëm nga profesionistët e auditimit dhe të tjerë të interesuar.

Komiteti i Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit:

Anëtarët e Komitetit i Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit, bazuar në nenin 21, të statutit të IEKAs, u miratuan me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 40 datë 27.09.2023 dhe vendim nr. 49 datë 06.09.2023.

Përbërja e Komitetit i Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit:

- | | |
|----------------|---------|
| • Kamela Hasko | Kryetar |
| • Arbër Gjata | Anëtar |
| • Alketa Cabej | Anëtar |
| • Ares Filto | Anëtar |
| • Ervis Kraja | Anëtar |

Komiteti i Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit harton dhe kryen mbarëvajtjen mbikëqyrjen e procesit të përgatitjes së programeve alternative dhe metodologjisë së auditimit.

Komiteti i Investigimit dhe Etikës

Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës bazuar në nenin 21, të statutit të IEKAs, u miratuan me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 40 datë 06.09.2023. Gjatë vitit 2023, ka kryer konstituimin e tij si dhe ka hartuar Draft-Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e tij. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e kërkesave ligjore për investigimin dhe propozimin e masave disiplinore nga ana e IEKAs, të vendosë rregulla dhe procedura për të garantuar të drejtat e palëve në këtë proces, verifikimin e ankesave të paraqitura pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar nga persona fizik ose subjekte juridike si dhe të gjitha rastet e deleguara për investigim nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike etj.

Në këtë rregullore janë të parashikuara dispozitat që rregullojnë propozimin e masave disiplinore ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, dërgimin e propozimeve pranë Këshillit Drejtues.

Ky komitet investigon sjelljet e anëtarëve të IEKA-s që bien në kundërshtim me:

- dispozitat e ligjit “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar” (i ndryshuar);
- aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- aktet statutore të organizatës; dhe me
- standardet profesionale dhe kodin e etikës.

Përbërja e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës, për vitin 2023 është si më poshtë:

1. Shpresa Breçani	Kryetar
2. Arian Çyrbja	Anëtar
3. Eldar Kazo	Anëtar
4. Nezir Kananaj	Anëtar
5. Taulant Naço	Anëtar

Ankesat drejtuar Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës gjatë këtij viti kanë të bëjnë kryesisht me çështjet si më poshtë:

- a. Evidentimi i disa shoqërive që mund të kenë kryer aktivitetin e auditimit ligjor ose përdorime titujve profesionale pa u regjistruar në Regjistrin Publik të IEKAs;
- b. Moszbatimi i kërkesave të SNSL 4400 “Angazhimi për kryerjen e procedurave të rënadakord” gjatë ushtrimit të profesionit nga një AL.
- c. Investigimi për ankesën e ardhur ndajnjë AL për pajtueshmërinë e ushtrimit të profesionit;
- d. Moszbatimi i kërkesave të Kodit të Etikës dhe procedurave të auditimit gjatë ushtrimit të profesionit të AL.

Me gjithë përpjekjet e shumë anëtarëve për të respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi, të rregulloreve, të statutit, si dhe kodit të etikës të IEKAs, përsëri në praktikë vazhdojnë të vërehen raste kur këto kërkesa nuk zbatohen plotësisht. Mangësi vërehen në procedurat e marrjes përsipër të angazhimeve/misioneve, në zbatimin e tarifave të ulëta, jo-konkurruese dhe të pamjaftueshme për një auditim cilësor sipas SNA-ve,

deklarime të pasakta në IEKA të angazhimeve të kryera dhe në veçanti mosdeklarimi i angazhimeve të ndryshme nga auditimi, siç janë raportet e ekspertëve për prokurorinë, gjykatën, raporte dhe shërbime të tjera, të cilat potencialisht mund të dëmtojnë profesionin e Audituesit Ligjor, nëse nuk respektojnë të njëjtën kërkesë etike sikurse edhe shërbime të tjera.

Viti 2023 njohu një rritje të mëtejshme të komunikimit të IEKAs me institucionet e pavarura dhe organet e tjera të administratës publike. Ky bashkëpunim i ka shërbyer rritjes dhe fuqizimit të rolit të profesionit, përmirësimit të cilësisë së punës dhe veçanërisht mbrojtjes së anëtarëve dhe të interesit publik. Zhvillimet ekonomike shoqërore të vendit e bëjnë gjithnjë e më të domosdoshme bashkëpunimin, në rradhë të parë midis anëtarëve apo segmenteve të ndryshme të profesionit dhe padyshim edhe me rregullatorët dhe aktorët e tjerë të pavarur e publikë. Thellimi i bashkëpunimit me organizatat e kontabilitetit në vend IKM, SHKFSH, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Integritetit, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Qendrën Kombëtare të Biznesit, me Universitetet (FEUT, UBT, etj), me Dhomat e avokatisë dhe të tregtisë, si edhe me shumë organe të tjera të administratës publike, ka njohur një shkallë mjaft cilësore gjatë gjithë vitit 2023.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

Në kuadër të bashkëpunimit institucional, me qëllim zbatimin sa më të mirë nga audituesit ligjorë të ligjit “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave”, “Për masat kundër financimit të terrorizmit” dhe udhëzimeve përkatëse në zyrat e DPPP-s u zhvillua një takim i përbashkët midis organeve drejtuese të IEKA dhe DPPP.

Çështjet të cilat u diskutuan në këtë takim ishin:

- Qartësimi i kërkesave ligjore - rregullore për detyrimin për raportim nga Audituesit Ligjorë;
- Standardizimi i kërkesave të Audituesve Ligjorë për raportim në DPPP;
- Bashkëpunimi për krijimin e një dokumenti me kërkesat ligjore për AL.
- Raportimi Online i Audituesit ligjor pranë DPPP/AFIU;

Gjatë vitit 2023, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar vijoi traditën e tij me konsolidimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me organizmat profesionale ndërkombëtare ku IEKA është anëtare aktive me të drejta të plota, siç janë:

FCM (*Federata e Ekspertëve Kontabël të Mesdheut*)

FCM është një shoqatë e krijuar në fund të vitit 1999 me iniciativën e drejtuesve të organizatave profesionale të vendeve të Mesdheut. Ajo mbledh së bashku organizatat profesionale të cilat veprojnë në vendet e Mesdheut dhe promovon bashkëpunimin midis organizatave profesionale në rajon, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, për të ndarë njohuritë dhe për të ofruar ndihmë teknike për anëtarët e saj dhe për t’i ndihmuar ata të arrijnë dhe mbajnë standarde të larta profesionale dhe të dhënies së sigurisë. IEKA është anëtare e FCM nga viti 2006.

Mbledhja e Këshillit të FCM u mbajt në Nëntor 2023, në Paris, France, në të cilën IEKA ishte pjesëmarrëse. Mbledhja u fokusua në zgjedhjen e presidentit të radhës të FCM. Ndër të tjerë në këtë

mbledhjetë Këshillit të FCM morën pjesë përfaqësues të CSOEC & CNCC Francë, ACCA, SCAAK etj.

EFAA (Këshilli i Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Audituesve për Ndermarrjet e Vogla dhe të Mesme)

Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (EFAA për SME-të) është një organizatë ombrellë për kontabilistët dhe organizatat e auditorëve kombëtarë, anëtarët individualë të së cilës ofrojnë shërbime profesionale kryesisht për NVM-të brenda Bashkimit Evropian dhe Evropës në tërësi. Është themeluar në vitin 1994.

EFAA për SME-të ka 15 anëtarë në të gjithë Evropën që përfaqësojnë mbi 380,000 kontabilistë, auditorë dhe këshilltarë tatimorë. EFAA për SME-të është anëtare e shoqatës së artizanatit dhe SME-ve (SMEunited) dhe një anëtar themelues i Grupit Këshillues Evropian të Raportimit Financiar (EFRAG).

Temat e trajtura në panelet e diskutimi ishin:

- zhvillimi i standardeve evropiane të raportimit të qëndrueshmërisë (ESRS) nga EFRAG;
- roli i firmave të vogla dhe të mesme të kontabilitetit në tranzicionin e qëndrueshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të Europës;
- ndërtimin e kapaciteteve të firmave të vogla dhe të mesme të kontabilitetit për të përgatitur raporte të qëndrueshmërisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Ndër të tjera, përfaqësuesit e organizatave Profesionale të Auditimit dhe Kontabilitetit, anëtarë të EFAA diskutuan dhe ndanë pikpamjet dhe sfidat e tyre me përfaqësuesit e Komisionit të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, duke u përfaqësuar në çështje me rëndësi të veçantë në mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij. Takimi i zhvilluar mes Organeve Drejtues të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Institutit të Kontabilistëve të Miratuar etj., me përfaqësues të Bankës Botërore gjatë vitit 2023 në kuadër të projektit "SQAR and REPARIS";

Doranin AGALLIU

Drejtor Ekzekutiv